



KRU **Hidroregjioni Jugor** sh.a. Prizren

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren
email: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

Procedurat per faturimin dhe leximin e konsumatoreve

Leximi i Ujëmatësit - ZYRA RREGULATORE PËR UJËSJELLËS DHE MBETURINA ("ZRRUM") (R-03/U&K) leshon këtë rregullore përveq tjerash edhe për:

Neni 26: Leximi i Ujëmatësit

26.1 Përpos në rastet kur është përcaktuar ndryshe me këtë Rregull, KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A. faturon Konsumatorët në bazë të konsumit të lexuar në Ujëmatës.

26.2 Leximi i Ujëmatësit bëhet nga lexuesi i Ujëmatësit apo inspektorëve nga , KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A. të kanë formë të përshtatshme të identifikimit (uniforma dhe karta e identitetit), të lëshuar nga KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A.dhe atë ta reklamojë në vend të dukshëm.

26.3 Leximi i ujëmatësit duhet të bëhet brenda orarit dhe ditëve të punës së i KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A. përderisa konsumatori duhet ti mundësoj lexuesit të ujëmatësit çasjen tek ujëmatësit brenda këtij orari.

26.4 Leximi i ujëmatësit nga KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A.bëhet një herë në muaj dhe së paku çdo tre muaj.

26.5 Leximi i Ujëmatësit mund të bëhet edhe nga Konsumatori, nëse KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A. dhe Konsumatori mirren vesh me shkrim për një formë të tillë. KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A. , në këto raste do të verifikojë gjendjen e Ujëmatësit në intervale të caktuara kohore, ashtu siç e konsideron të arësyeshme, por së paku një (1) herë në vit.

26.6 Në rastet kur Konsumatorët të cilët banojnë në objektet e banimit kolektiv, dhe faturimi i tyre bëhet në bazë të Ujëmatësit kryesor (të përbashkët), dëshirojnë të instalojnë Ujëmatësat individual, i KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A.duhet të iu krijojë atyre këtë mundësi, me kusht që një gjë e tillë është teknikisht e realizueshme. Të gjitha shpenzimet lidhur me instalimin e Ujëmatësit individual në këto raste i bart Konsumatori.

26.7 Në rastet kur Ujëmatësi është jofunksional për çfarëdo arsye dhe faturimi nuk mund të bëhet në bazë të konsumit të lexuar në Ujëmatës, atëherë faturimi për periudhën kohore derisa Ujëmatësi është jofunksional, do të bëhet në bazë të vlerësimit të bërë nga i KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A. i cili vlerësim duhet të bazohet në konsumin e realizuar në periudhën paraprake korresponduese të atij Konsumatori.

Neni 27: Verifikimi i Saktësisë dhe Kalibrimi i Ujëmatësve

27.1 KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A. në intervale të rregullta monitoron dhe teston saktësinë e Ujëmatësave dhe bënë kalibrimin e tyre sipas standardeve dhe normave të aplikueshme me ligjin për Metrologjinë dhe akteve nënligjore të cilat nxiren për këtë qëllim varësisht prej kërkesave të konsumatorëve dhe rregullorës së ZRRUK-ut. Shpenzimet për këto aktivitete të rregullta i bartë vetë i KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A. nese ujëmatësi nuk është në rregull ndersa kur ujëmatësi është në rregull atëherë shpenzimet i bartë vet konsumatori.

27.2 KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A. duhet ta verifikojë saktësinë e matjes së Ujëmatësit në rast se Konsumatori kërkon një gjë të tillë, përmes kërkesës së parashtruar me shkrim tek i KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A. Saktësia e matjes së Ujëmatësit vërtetohet me procesverbal.

27.3 Kostoja e verifikimit dhe kalibrimit të Ujëmatësit në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga Konsumatori bartet nga: (a) KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A., në rast se konstatohet se pasaktësia e matjes së Ujëmatësit është në dëm të Konsumatorit, (b) Konsumatori, në rast se konstatohet se ujëmatësi ka matur saktë konsumin e Ujit apo ka matur në dëm të KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A..

27.4 Nëse konstatohet se dështon verifikimi dhe kalibrimi i ujëmatësit nga ana e Konsumatorit, brenda afatit të dhënë, i KRU 'Hidroregjioni Jugor' Sh.A. faturimin për ujin e shpenzuar e bënë duke përdorur norma dhe metoda të përcaktuara nga Ofruesi i Shërbimit.